# DËSHMI ARKIVI

**A-447154**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | “Tango” e fundit për Messin, ‘Pleshti’ përgatitet për ndeshjen e lamtumirës me Argjentinën |
| ADRESA | `https://piranjat.al/sport/tango-e-fundit-per-messin-pleshti-pergatitet-per-ndeshjen-e-lamtumires-me--i104310` |
| BURIMI | piranjat.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 15 shtator 2026, 19:13:57 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 15 shtator 2026, 18:58:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `30795602b226f1608417b47a376ed66408007c66045c6d5639d3a0049811384f` |
| TEKSTI | `db68ab0db4c5c4ce22ff3963a986603a00e08a8df5d5a195edb9fc84b16865da` |
| PAMJA | `4e0beff8a1b90bf53b00ac33acaff0e1987c2b17362e03a7cfc99b8498a7f265` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `1d86c2f86fa2891eef58f65451d83d13a470c5f0a2ba8db22d6961e65af76628` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `7fc79e204ff2dfa3f9e677f0c9d1bacea0122705418ff355483188747d3235b5` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/1d86c2f86fa2891eef58f65451d83d13a470c5f0a2ba8db22d6961e65af76628`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

SPORT

# "Tango" e fundit për Messin, 'Pleshti' përgatitet për ndeshjen e lamtumirës me Argjentinën

Piranjat Përditësimi i fundit 15 Shtator 2026, 20:58



Lionel Messi duket se po i afrohet fundit të aventurës së tij me kombëtaren e Argjentinës. "Pleshti" pritet të rikthehet edhe një herë me fanellën bardhekaltër, në një ndeshje që mund të shënojë lamtumirën përfundimtare të një prej futbollistëve më të mëdhenj të të gjitha kohërave.

Sipas raportimeve të "ESPN Argentina" dhe gazetarit Federico Bueno, Federata Argjentinase e Futbollit po përgatit një grumbullim special për kapitenin e kampionëve të botës. Ideja është që Messi të ketë mundësinë të përshëndesë për herë të fundit tifozët argjentinas dhe t'i japë fund një epoke të jashtëzakonshme.

Edhe pse 39-vjeçari ka lënë të kuptohet se aventura e tij me kombëtaren po shkon drejt fundit, federata nuk dëshiron që kjo histori të mbyllet thjesht me një njoftim. Synimi është që lamtumira të jetë një mbrëmje madhështore, në fushën e blertë dhe përpara tifozëve që e kanë mbështetur gjatë gjithë karrierës së tij.

Messi ka shkruar historinë me Argjentinën. Me kombëtaren, ai ka fituar Kupën e Botës në Katar në vitin 2022, dy herë Copa América dhe medaljen e artë olimpike, duke e kurorëzuar një karrierë të jashtëzakonshme edhe në nivel ndërkombëtar.

Tashmë, Federata Argjentinase dëshiron t'i rezervojë kapitenit një lamtumirë në përputhje me madhështinë e tij. Një tjetër natë me fanellën bardhekaltër, një tjetër përshëndetje me tifozët dhe ndoshta 90 minutat e fundit të Messit me Argjentinën.

Nëse plani realizohet, ajo ndeshje do të shënojë fundin e një epoke. Një kapitull që nisi me ëndrra, u kurorëzua me Kupën e Botës dhe mund të mbyllet me një lamtumirë që do të mbetet gjatë në kujtesën e futbollit.

## Artikuj te sugjeruar


SPORT 15 Shtator19:59

### [Kristian Shpendi për rekord, sulmuesi i Kombëtares një gol larg historisë]

Kristian Shpendi po përjeton një nisje fantastike të sezonit me Çezenan. Sulmuesi shqiptar ka realizuar pesë gola në katër ...

SPORT 15 Shtator19:07

### [Kombëtarja merr goditjen e fortë, 4 mungesa të rëndësishme për ndeshjet e Nations League; Maran rikthen dy yje]

Kombëtarja shqiptare pritet të përballet me disa mungesa të rëndësishme në grumbullimin e radhës, me dëmtimet q&eum...

SPORT 15 Shtator18:58

### [Messi përshëndet të gjithë fëmijët para se të zbresë në fushë]

Pak para se të zbriste në fushë, Lionel Messi u ndal për të përshëndetur fëmijët që ishin rreshtuar krah futbo...

SPORT 15 Shtator17:43

**VIDEO/ Atletja australiane pëson diarre të pakontrollueshme, por shihni si vazhdon garën pa u ndalur**

Një moment i sikletshëm gjatë një gare HYROX në Kinë për atleten australiane Joanna Wietrzyk. Gjatë garës, atlet...

SPORT 15 Shtator15:41

**FSHF në pritje të listës së Klopp, Brajan Gruda rrezikon të mbyllë përfundimisht kapitullin kuqezi**

Trajneri i Kombëtares shqiptare, Rolando Maran, do të publikojë këtë të premte listën e tij të parë sa i për...

SPORT 15 Shtator15:35

**Coutinho bashkohet me Neymarin! 34-vjeçari rikthehet në fushë, firmos me Santos deri në fund të vitit**

Philippe Coutinho rikthehet në futboll dhe firmos me Santos, ku do të luajë përkrah mikut të tij Neymar. Dy yjet brazilianë do t...

SPORT 15 Shtator15:27

**Barça, Flick nuk fshihet: Dua finalen e Champions!**

Hansi Flick nuk e fsheh dëshirën për të përjetuar një nga momentet më të mëdha të karrierës së tij...

SPORT 15 Shtator14:58

**Shqiptarët shkëlqejnë në Serie A/ Rrahmani dhe Zhegrova në formacionin e javës, nota 9.2 për yllin e Juventusit**

Në javën e katërt të Serie A, dy nga lojtarët shqiptarë shkëlqyen me skuadrat e tyre, duke bërë që të j...

SPORT 15 Shtator14:46

**Shpërthen 'bomba' në Spanjë! Çesk Fabregas projektohet si pasues i Hansi Flick te Barça**

Emri i Çesc Fàbregas po fiton gjithnjë e më shumë rëndësi brenda Barcelonës si një trajne...

SPORT 15 Shtator14:29

**Triumfoi në Kupën e Botës, Federata Spanjolle shpërblen trajnerin Luis de La Fuente me kontratë të re**

Luis de La Fuente është shumë pranë nënshkrimit të kontrarës së re me Federatën Spanjolle të futbollit. Traj...

## ME TE VIZITUARAT

BOTA 15 Shtator

**Sulmohet Arabia Saudite, bombardohet me raketa ...**

Huthët e Jemenit, të mbështetur nga Irani, kanë nisur një valë të re sulmesh ndaj Arabisë Saudite, ndërsa paralel...

BOTA 14 Shtator

**"E drog*va dhe abuz*va gruan për 20 vite"/ Bash...**

Një burrë britanik pranoi sot se kishte droguar dhe përdhunuar gruan e tij në shtëpinë e tyre për rreth dy dekada. Burri, ban...

AKTUALITET 15 Shtator

**Rrëfehet 34-vjeçarja: Daja i Zegjine Caushit më...**

Një ngjarje e rëndë ka ndodhur pak ditë më parë në Roskovec, ku Bledar Bakaj shkoi në shtëpinë e ish-bashk&e...

INVESTIGIME 31 Maj14:01

**Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik**

Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...

### video





Çdo të premte | ? 20:45 | ???? Syri TV





**Çdo të premte | ? 20:45 | ???? Syri TV**




**Si u tentua të shantazhohej me 100 mijë euro shefi i kabinetit të Përparim Ramës përmes mediave**




**PIRANJAT SHOW - SEZONI 9 EPISODI 16**



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.